



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.21, dt.17.03.2020

MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR SUBJEKTET PËRFITUES NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE TË REJA DHE PROGRAMI I GRANDEVE TË RINDËRTIMIT NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 18, të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, nenit 15, pika 3, të Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", pikës 11, të vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

- Miratimin e sistemit të pikëzimit për subjektet që kanë aplikuar për të përfituar nga programi i zhvillimit të objekteve të reja dhe programi i grandeve të rindërtimit në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit dhe programeve të tuj, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi dhe Administrimin e Njësive Administrative të Emergjencave Civile për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARI

